

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Nr. 02-35/23-06

Prishtinë, më 27 tetor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 79 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Koha për pyetjet e deputetëve,
3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditimit Gjeneral për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosoves, dhe
4. Shqyrtimi i Raportit për punën e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2005

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që pika e tretë – shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm të shtyhet për ndonjë seancë tjetër. Ai e arsyetoi kërkesën duke e cituar shkresën e Auditorit se Raporti nuk është përfundimtar dhe nuk përmban opinione dhe komente të kualifikuara nga ekspertët e Zyrës së Auditimit. Raportin e kompletuar të auditimit të jashtëm duhet ta shqyrtojë Komisionin i Buxhetit dhe i Financave dhe t'i rekomandojë Kuvendit për veprimet e mëtejme.

Kryetari kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen lidhur me kërkesën e grupit Parlamentar të LDK-së.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi pauzë për të konsultuar lidhur me kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Gjyylanze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e mbështeti kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Teutë Sahatçiu, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-së, tha se raporti i Auditorit të Përgjithshëm duhet të shqyrtohet sipas rendit të ditës të kësaj seance.

Numan Baliq, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, kërkoi që kryetarët e grupeve parlamentare të konsultohen lidhur me kërkesën e kryetarit të Grupit parlamentar të LDK-së.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha** kërkoi që raporti i Komisionit për Shëndetësi për zbatimin e Ligjit për shëndetësi të radhitet në rend dite të kësaj seance për shqyrtim.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----48;
Kundër-----30;
Abstenime----- 9.

Kryetari konstatoi: Kuvendi miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për ta shtyrë shqyrtimin e Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe ata të ORA-së, në shenjë pakënaqësie e lëshuan seancën.

Kryetari dha pauzë 15 minuta.

Pas pauzës në seancë ishin të pranishëm 48 deputetë.

Kryetari në mungesë të kuorumit seancën e sotme e deklaroi të mbyllur.

E premte, 3 nëntor 2006

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Të pranishëm ishin 88 deputetë.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur dje më 2 nëntor 2006, e ka rishikuar rendin e ditës të propozuar për seancën plenare të datës 3 nëntor 2006, të cilin e ka konfirmuar dhe ka vendosur t'i propozohet seancës plenare, që pas debatit lidhur me Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës, të hidhet në votim propozimi për formimin e Komisionit Hetimor.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se

Në bazë të shkresës së Zyrës së Auditorit Gjeneral, të 31 tetorit 2006, me të cilën konfirmohet se Raporti për të gjeturave faktike të Kuvendit të Kosovës është përfundimtar. Pra, sipas të dhënave të fundit për ne pushojnë arsyet e heqjes së kësaj pike nga rendi i ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Gani Koci** pyeti ministrin e Ekonomisë dhe të Financave për numrin e objekteve private që i shfrytëzon Qeveria e Kosovës dhe për çmimin që ajo e paguan në emër të qirasë.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputeti Koci..

Deputetja **Sala Berisha** pyeti ministrin e Ekonomisë dhe të Financave shumën e mjeteve të paguara për projektin për hulumtime gjeologjike.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Shala.

Deputeti **Ibush Jonuzi** pyeti ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me zbatimin e kontratave nga ndërmarrjet e privatizuara me spinof special lidhur me numrin e punësimit dhe shumën e investimeve.

Ministri **Bujar Dugolli** u përgjigj pyetjes së deputetit Jonuzi..

Deputeti **Hydajet Hyseni** ripërsëriti pyetjen për Qeverinë e Kosovës lidhur me mënyrën shpenzimit të mjeteve për zbutjen e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit, si dhe parashtrroi pyetje shtesë se cili është qëndrimi i Qeverisë ndaj Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për shpenzimet e cekura më lartë?

Përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetit Hyseni.

Deputeti **Nait Hasani** parashtrroi pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me dëmtimet arkeologjike afër kishës Shën Gjergji në Prizren.

Ministri **Astrit Haraçia** nuk i ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputeti Hasani.

3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditimit Gjeneral për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës

Kryetari e ftoi parashtruesin e mocionit të merë fjalën.

Deputeti **Gazmend Muhaxheri**, në emër të propozuesit të mocionit, tha se institucioni i cili duhet të ishte mbrojtës i ligjshmërisë dhe i rendit është shkelësi më i madh. Sot po shqyrtojmë raportin e Auditorit Gjeneral për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës jo për të gjykuar ish kryetarin e Kuvendit të Kosovës, por për të gjykuar një fenomen, që po i gërryen themelet e institucioneve të Kosovës, e ky është keq përdorimi i pozitës zyrtare. Me keqpërdorim të pozitës zyrtare po vihet në rrezik e ardhmja e Kosovës.

Mira punëtorë të ndershëm të administratës civile në Kosovë janë dëshmitarë të keqpërdorimeve abuzive dhe korrupsionit në institucionet tona, të kryera nga ministra, sekretar permanent, drejtor buxheti, drejtor prokurimi.

Në të gjitha veprimet e paligjshme, keqpërdorimet dhe hajnit ka së paku një dëshmitar, një njeri i ndershëm që sot hesht. Në papunësi që të ndryshojë situatën e krijuar dhe disa prej këtyre njerëzve të ndershëm largohen nga këto institucione, disa të tjerë presin se do të vij ditët më të mira. Ne, Kuvendi i Kosovës, duhet të përipiqemi që këtyre njerëzve t'u dërgojmë mesazh se do të vinë ditë më të mira dhe nuk do të tolerohen keqpërdorimet.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se nga shkresa që u është shpërndarë deputetëve bëhet me dije se lënda është dërguar në hetuesi. Po njashtu, bëhet me dije, në letrën e mëhershme, se këto të dhëna janë njëburimore, për të cilat nevojitet verifikim.

Për mënyrën e verifikimit parlamentar ekzistojnë disa mundësi. Mund të kryhet verifikimi përmes Komisionit të Buxhetit apo të formohet një komision i posaçëm.

Ne nuk e prejudikojmë rezultatin final të këtyre të gjetura, por zotohemi për të mos ndërhyrë në punë gjatë hetimeve. Andaj, si Grup Parlamentar qëndrimin tonë do ta japim pas të dhënave përfundimtare për këtë çështje.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se Raporti Auditorit të Përgjithshëm, që e kemi në shqyrtim, po i konfirmon keqpërdorimet e shumta, që ne si opozitë i kemi ngritur me kohë.

Për keq menaxhimin e parave publike nga ana e ish kryetarit të Kuvendit edhe në legjislaturën e kaluar është folur, por jo nëpër këto masa që sot i kemi në raportin e Auditit të Përgjithshëm. Këto fakte janë shqetësuese, sepse këto kanë ndodhur në institucionin që duhet t'i kontrollojë institucionet tjera për shfrytëzimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Në këto shkelje të rënda ish kryetari i Kuvendit, me drejtuesit e administratës së tij, nuk kanë qenë vetëm. Ata janë ndihmuar nga shumë filtra të tjerë të ekzekutivit.

Me këto forma të udhëheqjes e të menaxhimit Kosova vështirë se do të përmbushë standardet për qytetarët e saj në rend të parë.

Raporti i auditimit afron të dhëna të bollshme se në Kuvendin e Kosovës ka ndodhur vjedhje ordinere e buxhetit.

Prandaj, ne kemi kërkuar disa herë formimin e Komisionit Hetimor për të hetuar të gjitha njësitet që e kanë shfrytëzuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, që nga janari i vitit 2002 e këndej.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se angazhohen për qeverisje të mirë dhe menaxhimin efikas e produktiv të mjeteve publike dhe dënon çdo lloj keq përdorimi të tyre.

Shqyrtimi i Raportit do të ishte më i plotë sikur të përmbante vlerësimin profesional të fakteve të gjetura për Kuvendin e Kosovës, sidomos për dy çështje të rëndësishme -keq menaxhimin dhe keq përdorimin e buxhetit.

Ky raport nuk paraqet një vlerësim, por konkluzat për faktet e gjetura. Nga ana tjetër, duhet të marrim parasysh procedurat hetimore që janë iniciuar nga prokuroria, ne këtu nuk duhet t'i gjykojmë askënd, ngase përgjegjësia penale e individëve është duke u hetuar nga prokuroria, dhe nuk duhet të pengojmë ose të ndikojmë në hetime. Gjithashtu, nuk mund t'i mbyllim sytë ndaj fakteve të prezantuara në këtë raport, të cilat tregojnë qartë se mjetet buxhetore të Kuvendit të Kosovës të dedikuara për shpenzime publike janë përdorur për shpenzime private. Raporti në mënyrë të qartë zbardhë raste kur mjetet buxhetore ku janë përdorë për qëllime private për disa persona dhe këto veprime i dënojmë publikisht.

Kërkojmë që të gjithë ata, që i kanë shpërdorur mjetet publike, të thirren në përgjegjësi dhe të përgjigjen para ligjit.

Mbështesim të gjitha nismat që ngrisin nivelin e përgjegjësisë, vënies së rregullit dhe funksionimit më të mirë të Kuvendit të Kosovës.

Teutë Sahatçiu, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha Raporti i Auditorit të Përgjithshëm tregon se gjithë aktiviteti i keqpërdorimit nuk ka mund të kryhet vetëm nga një njeri. Fatkeqësisht ka ngërthyer brenda vetes shumë të tjerë. Involvimi i shumë aktorëve, veprimi i planifikuar, i organizuar dhe me logjistikë të përkryer veprimi, që përfshinte të gjitha nivelet si në Kuvend, në Prokurim, Thesarin dhe Ministrinë e Ekonomisë.

Në Kuvend janë porosit dy vetura, që kushton 750 mijë €, duke i anashkaluar të gjitha procedurat. Ato nuk kanë arritur fare, por janë nënshkruar se kanë ardhur.

Në të njëjtën vazhdohet të derdhen miliona € për ndërtimin e QAP "Gërmia".

Prandaj, Grupi ynë parlamentar propozon të formohet Komisioni Hetimor për t'i hetuar të gjitha keqpërdorimet, i cili duhet të udhëhiqet nga opozita. Komisioni duhet t'i raportojë Kuvendit pas një muaji.

Numan Baliq, në emër të Grupit parlamentar për Integrim, tha se Od onog momenta kada je ovaj predmet došao na razmatranje do danas desilo se nekoliko važnih slučajeva posebno sa aspekta pravnog djelovanja. Najpre su se desile zamjene, potom smo imali i otvaranje sudskih procesa i hapšenja. Mislim da je bio veoma bitno da danas imamo informaciju oko toga šta je bilo, zašto su ljudi uhapšeni i šta je nadjeno vezano za hapšenjima koja su sprovedena. Mi imamo ne želimo da učestvujemo unutar partijskim i medjupartijskim

razračunjavanjima, a posebno u onima koji daleko prelaze granicu normalnog političkog ponašanja. Mi se zalažemo za pravdu, ali ću nastojati da budemo na pravome putu i da podržimo sve prave odluke sudskih organa.

Ovaj je dobar početak, što se počelo od Parlamenta, neka to bude znak za nastavljanje ovoga u svim drugim institucijama u zemlji. Slažemo sa inicijativama da se formira komisija za ispitivanje ovog slučaja. U toj komisiji treba uzeti učešće sve političke strukture i sve etničke zajednice i da o tome Parlament mora biti redovno izvještavan.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës dhanë edhe këta deputetë: **Fadil Geci, Gani Koci, Berat Luzha, Melihate Tërmkollli, Selvije Halimi, Ramë Buja, Ramdan Kelmendi, Hydajet Hyseni, stafete Hadërgjonaj, Hajredin Hyseni, Lulzim Zeneli, Bajram Rexhepi, Enver hoxhaj, Hajredin kuqi, Besa gaxheri, Xhavit haliti, Nekibe kelmendi, Behxhet Brajshori, Ymer Haalimi, Bajrush Xhemajli, Nait Hasani, Sala Ahmetaj, Sokol Bashota, Genc Gorani, Sanije Zeqiraj, Ylber Hysa, Xhelal Canziba, Sala Berisha dhe Sabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Në fund të debatit, kryetari e hodhi në votim propozimin për formimin e Komisionit Hetimor. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----58;

Kundër----- 5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori vendim për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për të bërë hetimet lidhur me Raportin e për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës.

Kryetari dha pauzë 30 minuta për t'u konsultuar kryetarët e grupeve parlamentare lidhur me emrat e anëtarëve të këtij komisioni që do t'ia paraqesin Kuvendit për miratim.

Pas pauzës kryetari i paraqiti propozimin, i harmonizuar nga kryetarët e grupeve parlamentare, për anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar. Ai i hodhi në votim kandidatët e propozuar për anëtar të komisionit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër-----3;

Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këtë

V e n d i m **për formimin e Komisionit Hetues parlamentar**

1. Formohet Komisioni hetues parlamentar, në këtë përbërje:

1. Ferid Agani, Për Integrim , kryetar ,
2. Lutfi Zharku, LDK, nënkryetar i parë,
3. Husnija Beshkoviq, 6+ , nënkryetar i dytë,
4. Naser Osmani, LDK, anëtar,
5. Ali Sadriu, LDK, anëtar,

6. Besa Gaxheri, LDK, anëtar,
 7. Shaban Halimi, LDK, anëtar,
 8. Nimon Alimusaj, LDK, anëtar,
 9. Gazmend Muhaxheri, ORA , anëtar,
 10. Mazllom Kumnova , AAK , anëtar,
 11. Gani Koci, PDK , anëtar,
 12. Afrim Arzualgjiu PDK, anëtar,
 13. Safete Hadergjonaj, PDK, anëtar dhe
 14. Snezana Milic, SLKM, anëtar.
2. Komisioni Hetimor parlamentar ka tërë autoritetin e Komisionit FunkSIONAL për të bërë hetime lidhur me Raportin për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës dhe që ta ftojë secilin zyrtar të Kosovës për të dëshmuar para komisionit lidhur me çështjen nën hetime.
 3. Komisioni Hetimor parlamentar duhet që në mbledhjen e parë ta miraton Rregulloren e punës së vet.
 4. Komisioni do të fillojë me punë menjëherë, ndërsa punën duhet ta përfundojë deri më 31 dhjetor 2006.
 5. Kompensimi për punën e anëtarëve të komisionit do të bëhet sipas kriterëve për punën e komisioneve funksionale të Kuvendit.
 6. Ngarkohet sekretari i Kuvendit për krijimin e kushteve për mbështetje të punës së Komisionit.

Pas përfundimit të kësaj pike, kryetari tha se shqyrtimi raportit për punën njëvjeçare të ART-së shtyhet për seancën e radhës.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 17:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale